



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA SHTETËRORE E
KADASTRËS

DHOMA KOMBËTARE E
NOTERËVE

15614/2 30.11.23

ANEKS 1/1

“PËR DISA NDRYSHIME NË PROTOKOLLIN TEKNIK TË NDËRVEPRIMIT ASHK-NISA (ANEKSI 1) TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NR.185 PROT ; NR.2729 PROT. DATË 08.01.2020, TË LIDHUR MIDIS AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS DHE DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERËVE”

Ky Aneks nënshkruhet sot në datë 30/11 2023 bazuar në pikën 4, të nenit 10 “Dispozita të fundit”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur midis Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Dhomës Kombëtare të Noterëve, me nr.185 Prot - ASHK; dhe nr. 2729 Prot - DHKN datë 08.01.2020.

Palët në Marrëveshje bien dakord që në Aneksin 1, “Protokolli teknik i ndërveprimit ASHK-NISA”, të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Në gjermën “B”, Rregullat dhe Procedurat e Kërkesave Online, paragrafi i katërt të ndryshohet si vijon:

“Me administrimin nëpërmjet sistemit elektronik të kërkesës, dokumentin noterial¹ dhe cdo dokumentacion tjetër, të nënshkruar elektronikisht² nga noteri sipas kriterëve ligjore referuar akteve ligjore në fuqi, nëpërmjet sistemit “NISA”, ASHK kryen verifikimin e dokumentacionit sipas afateve të parashikuara në Vendimin e Këshillit Drejtues nr.15, datë 30.09.2022, “Për miratimin e listës së shërbimeve

¹ Ligji nr.110/2018 “Për noterinë”

Neni 126 “Procedurat për kalimin e pasurisë së paluajtshme”-

1.Akti noterial për kalimin ose njohje në pronësië mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to , kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e pales nëpërmjet sistemit elektronik mbi pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij verifikimi, pala i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të nevojshme, si dhe autorizimin e saj me shkrim.

2.Noteri shënon në aktin noterial për kalimin e pasurisë së paluajtshme, verifikimin e bërë dhe i bashkëlidh rezultatin e verifikimit.

² Ligj nr.10273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”

Neni 5 “Vlefshmëria ligjore e dokumentit elektronik” - Dokumenti elektronik ka vlefshmëri ligjore vetëm në ato raste kur ai krijohet, dërgohet, merret, mbahet dhe ruhet, duke zbatuar teknologjitë e informacionit, nëpërmjet kompjuterëve, sistemeve kompjuterike, pajisjeve të ngjashme dhe programeve elektronike, duke përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenet 6, 7 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 6 “Kritere të dokumentit elektronik” – “Përgjatë ciklit të dokumentit, në veprimet e përfshira në të, dokumenti elektronik duhet të sigurojë:

a) nënshkrim elektronik dhe/ose vulë elektronike, sipas legjislationit në fuqi për nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara;

kadastrale që mund të ofrohen në mënyrë të përsheptuar, tarifave të diferencuara dhe afateve të trajtimit”. Kur dokumentacioni është në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi dhe akti noterial i paraqitur parashikon pagesën e tatimit/taksës, ASHK përllëgarit detyrimet dhe dërgon nëpërmjet sistemit, formularin përkatës. Në rast pasaktësie në plotësimin e kërkesës, mungese në dokumentacion, apo mungese të nënshkrimit elektronik, ASHK nëpërmjet kërkesës për plotësim dokumentacion, (AV0), kërkon plotësimin e pasaktësisë dhe mungesave.

2. Në gërmën “B”, Rregullat dhe Procedurat e Kërkesave Online, paragrafi i shtatë të ndryshohet si vijon:

“Me dërgimin e kërkesës, dokumentit noterial dhe çdo dokumentacioni tjetër, secili i nënshkruar elektronikisht nga noteri, secili në format “PDF”, dhe me kryerjen e pagesës sipas afateve, noteri ka detyrimin:

a) Për shërbimet kadastrale standarte, të depozitojë në protokollin e ASHK-së jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës nëpërmjet sistemit, aktin noterial dhe dokumentacionin shoqërues, në origjinal dhe në format analog, nëpërmjet shërbimit postar.

b) Për shërbimet kadastrale të përsheptuara, të depozitojë të depozitojë në protokollin e ASHK-së brenda ditës, përmes shërbimit postar, aktin noterial dhe dokumentacionin shoqërues në origjinal dhe në format analog.

Dokumentimi i dorëzimit në format analog, nëpërmjet shërbimit postar të dokumentacionit nga noteri, kryhet nga ASHK në librin e protokollit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

Ky Aneks hyn në fuqi në datën ___ / ___ 2023.

**AGJENCIA
SHTETËRORE E KADASTRËS**
Drejtor i Përgjithshëm



**DHOMA
KOMBËTARE E NOTERËVE**
Kryetar

Mimoza SADUSHAJ

